



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2022-01

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 shkurt 2023

Gjuha e origjinalit: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Shtojca 1 e Aktgjykimit të Apelit – Historiku Procedural

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:
Tobi Kadman

1. Më 17 qershor 2022, ZPS-ja kërkoi që Paneli i Gjykatës së Apelit të linte në fuqi mbajtjen në paraburgim të të akuzuarve, në pritje të vendimit mbi apelet e paraqitura kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykses.¹
2. Më 30 qershor 2022, Paneli miratoi kërkesën e tretë të Gucatit për lirim të përkohshëm për arsye humanitare.²
3. Më 28 korrik 2022, me kërkesë të ZPS-së, Paneli konfirmoi se të akuzuarit do të vazhdoreshin të mbaheshin në paraburgim në pritje të apeleve të tyre, përveç nëse Paneli lëshonte një urdhër të ndryshëm.³
4. Më 13 shtator 2022, Paneli miratoi kërkesën e katërt të Gucatit për lirim të përkohshëm për arsye humanitare.⁴
5. Më 15 shtator 2022, pas njoftimit të ZPS-së për dy komunikime konfidenciale dhe *ex parte*, Paneli urdhëroi ZPS-në që, sipas rregullës 103 të Rregullores, t'i nxirrte Mbrojtjes dy intervista të dëshmitarit W04730, dhe t'i jepte Mbrojtjes, sipas rregullës 102(3) të Rregullores, njoftim të hollësishëm për komunikimin e dytë të marrë nga ZPS-ja.⁵
6. Më 23 shtator 2022, Paneli miratoi kërkesën e ZPS-së për masa mbrojtëse në lidhje me dy intervistat e dëshmitarit W04730.⁶
7. Më 17 dhe 18 tetor 2022, në kontekstin e shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të detyrimit për nxjerrjen e materialit prej ZPS-së, të akuzuarit dorëzuan mocione për

¹ Njoftimi i ZPS-së lidhur me Apelin, para. 2-4.

² Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Tretë të Gucatit për Lirim për Arsye Humanitare, para. 15, 18, 22.

³ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e ZPS-së për Mbajtjen në Paraburgim, para. 12.

⁴ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Katërt të Gucatit për Lirim për Arsye Humanitare, para. 20, 23, 27.

⁵ Njoftimi i Parë i ZPS-së lidhur me Komunikimin e Marrë nga ZPS-ja; Njoftimi i Dytë i ZPS-së lidhur me Komunikimin e Marrë nga ZPS-ja; Vendimi i Apelit mbi Njoftimet e ZPS-së.

⁶ Kërkesa e ZPS-së për Masa Mbrojtëse; Vendimi i Apelit në lidhje me Kërkesën e ZPS-së për Masa Mbrojtëse, para. 13, 15.

mjet juridik alternativ, ku i kërkuan Panelit të Apelit të prapësonte verdiktet e fajësisë dhe (i) të shpallte pafajësinë, (ii) të urdhëronte pezullim e procesit, ose (iii) të urdhëronte rigjykim.⁷

8. Më 21 tetor 2022, pas kërkesës së ZPS-së për mosnxjerrjen e komunikimit të dytë të lartpërmendur (të identifikuar nga palët si “materiali 206”), Paneli vendosi që ky material të mos i nxirrej Mbrojtjes.⁸

9. Më 7 nëntor 2022, Paneli hodhi poshtë mocionet e Mbrojtjes për mjet juridik alternativ lidhur me shkelje të nxjerrjes së informacionit sipas rregullës 103 të Rregullores.⁹

10. Më 9 nëntor 2022, Paneli miratoi kërkesat e Mbrojtjes për zgjatje të afatit me 14 ditë pasi Paneli të vendoste mbi kërkesat e pashqyrtuara të Mbrojtjes për të kontaktuar dëshmitarë me qëllim që të dorëzonte një mocion të mundshëm për prova shtesë.¹⁰

11. Më 16 nëntor 2022, Paneli hodhi poshtë kërkesën e Haradinajt për lirim të përkohshëm për arsye humanitare.¹¹

12. Më 28 nëntor 2022, Paneli hodhi poshtë, ndër të tjera, kërkesat e të akuzuarve për mundësimin e intervistave me disa dëshmitarë ose nxjerrjen e të dhënave të

⁷ Mocioni i Gucatit për Mjet Juridik Alternativ; Mocioni i Haradinajt për Mjet Juridik Alternativ.

⁸ Njoftimi dhe Kërkesa e ZPS-së në lidhje me Materialin 206; Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e ZPS-së në lidhje me Materialin 206. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e Gucatit ndaj Kërkesës së ZPS-së në lidhje me Materialin 206; Përgjigja e Haradinajt ndaj Kërkesës së ZPS-së në lidhje me Materialin 206.

⁹ Vendimi i Apelit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mjete Juridike Alternative lidhur me Shkeljen e Detyrimit të Nxjerrjes së Materialit sipas Rregullës 103.

¹⁰ Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit lidhur me Mocione për Prova Shtesë; Kërkesa e Gucatit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Mocionit në lidhje me Provat Shtesë; Kërkesa e Haradinajt për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Mocionit në lidhje me Provat Shtesë.

¹¹ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Haradinajt për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare.

kontaktit të tyre, dhe për urdhër për njoftim të përditësuar sipas rregullës 102(3) të Rregullores.¹²

13. Më 30 nëntor 2022, Paneli hodhi poshtë kërkesën e Gucatit që Paneli i Gjykatës së Apelit të zbulonte çfarë dinte lidhur me hetimet e Mbrojtjes.¹³

14. Më 1 dhjetor 2022, Paneli hodhi poshtë kërkesën e Haradinajt për shtyrjen e seancës së apelit.¹⁴

15. Më 9 janar 2023, pas kërkesës së Gucatit, Paneli urdhëroi palët të dorëzonin versione të redaktuara publike të disa parashtrimeve të protokolluara, ose të paraqisnin parashtrime se pse kjo nuk ishte (ende) e mundshme.¹⁵

16. Më 16 janar 2023, Paneli hodhi poshtë kërkesën e Haradinajt për të urdhëruar ZPS-në të nxirrte materiale sipas rregullave 102(3) dhe 103 të Rregullores.¹⁶

17. Më 31 janar 2023, në zbatim të Vendimit të Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit, Paneli (i) miratoi kërkesën e Gucatit dhe nxori versionet e redaktuara publike të shtatë vendimeve në fjalë të Panelit të

¹² Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Intervistimin e Dëshmitarëve, para. 22, 28, 31. *Shih* Kërkesa e Gucatit për Intervistim të Dëshmitarëve; Kërkesa e Haradinajt për Intervistim të Dëshmitarëve.

¹³ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Nxjerrje të Plotë të Informacionit lidhur me Dijeninë e Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me Hetimet e Mbrojtjes; Kërkesa e Gucatit për Nxjerrje të Plotë të Informacionit lidhur me Dijeninë e Panelit të Gjykatës së Apelit për Hetimet e Mbrojtjes.

¹⁴ Urdhri Gojor lidhur me Kërkesën e Haradinajt për Shtyrje të Seancës së Apelit; Kërkesa e Haradinajt për Shtyrje të Seancës së Apelit.

¹⁵ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikimin e Vendimeve të Gjykatës së Apelit; Kërkesa e Gucatit për Riklasifikim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit.

¹⁶ Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Haradinajt për Nxjerrjen nga ZPS-ja të Materialeve të Rregullës 102(3) ose Rregullës 103; Kërkesa e Haradinajt për Nxjerrjen nga ZPS-ja të Materialeve të Rregullës 102(3) ose Rregullës 103.

Apelit,¹⁷ dhe (ii) miratoi kërkesat e Haradinajt dhe të ZPS-së dhe urdhëroi riklasifikimin e parashtrimeve origjinale.¹⁸

¹⁷ Vendimi i Mëtejshëm i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim; Kërkesa e Gucatit për Riklasifikim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit mbi Njoftimet e ZPS-së; Vendimi i Apelit në lidhje me Kërkesën e ZPS-së për Masa Mbrojtëse; Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e ZPS-së në lidhje me Materialin 206; Vendimi i Apelit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mjete Juridike Alternative në lidhje me Shkeljen e Detyrimit të Nxjerrjes së Materialit sipas Rregullës 103; Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit lidhur me Mocione për Prova Shtesë; Vendimi i Apelit mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Intervistim të Dëshmitarëve; Vendimi i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Nxjerrje të Plotë të Informacionit lidhur me Dijeninë e Panelit të Gjykatës së Apelit për Hetimet e Mbrojtjes.

¹⁸ Vendimi i Mëtejshëm i Apelit mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim; Kërkesa e ZPS-së për Riklasifikimin e Parashtrimin F00089; Kërkesa e Haradinajt për Riklasifikimin e Kërkesës F00088. *Shih gjithashtu* Kërkesën e Haradinajt për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Mocionit në lidhje me Provat Shtesë; Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesave për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin në Apel të Mocioneve për Prova Shtesë.